Cette Apostille atteste uniquement la véracité de la signature, la qualité en laquelle le signataire de l'acte a agi et, le cas échéant, l'identité du sceau ou timbre dont cet acte public est revêtu.

Cette Apostille ne certifie pas le contenu de l'acte pour lequel elle a été émise.

[L'utilisation de cette Apostille n'est pas valable en / au Espagne.]

[Cette Apostille peut être vérifiée à l'adresse suivante <https://sede.mjusticia.gob.es/eregister>]

Code de vérification de l'Apostille: NA:ELeD-V7jE-OVs2-bQOO

Letër e posacme për dokumente noteriale

JAVIER GASPARD ALFARO

NOTER

General Mola, 12-1, Doha.

Tel. 225 41 82 – MADRID

A7016927

REGJISTRI TREGTAR I MADRIDIT

Paraqitur në orën 11 e 30 minuta

Më 16 dhjetor 1966

NUMRI TREMIJË E TREQIND E SHTATËDHJETË E DY

Në Madrid, më njëzetë e katër Tetor të vitit njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë

Para meje, JAVIER GASPARD ALFARO, Noteri Publik i Kolegjit Noterial të këtij Kryeqyteti, me seli në të njëjtën, -

PARAQITEN:

Z.MIGUEL CASTILLO SALVADIOS, në moshë madhore, i martuar, Inxhinier Industrial dhe me vendbanim në Madrid - Fernan do el Católico, 80 , me D.N.I numër 280.609 të datës 14 Tetor 1963

Z.RAMÓN MARIA DE ZABALA CASTILLO, në moshë madhore, martuar me Znj. Hannelore Hartëig, me profesion inxhinier civil dhe me vendbanim në Madrid- Aravaca, Francisco Sanfiz, 9, me dokumentin e identitetit kombëtar, numër 34043 të datës 8 Tetor 1965.

Z. JOSE IGNACIO CASANOVA FERNÁNDEZ, në moshë madhore, martuar me Znj. Amalia Machinbarrena Monedero, Arkitekt dhe me vendbanim në Madrid - Alvarez Baena, 5 , me dokumentin kombëtar të identitetit N2.1970590 të datës 10 Shkurt 1964.

Z. PABLO BUENO SAINZ, në moshë madhore, martuar me Znj.Dolores Tomás Gallego, me profesion Inxhinier Ndërtimi dhe me vendbanim në Madrid - Santiago Bernabeu, 7 me D.N.I. numër 33.266 të datës 21 maj 1962.



Z. LUIS AYUSO TEJERIZO, në moshë madhore, i martuar me znj. Mercedes Menéndez Iñiguez, i diplomuar në Filozofi dhe Letërsi dhe me vendbanim në Madrid, dalle Áraiz, numër 11, me dokumentin kombëtar të identitetit, numër 858.546 të datës 13 janar 1965

DHE Z. JAVIER RODRIGUEZ-SASTRE DIAZ, në moshë madhore, martuar, Avokat dhe me vendbanim në Madrid, Marcelino Santa, 8, me numër D.N.I 28221848 të datës 11 shkurt 1965.

Të gjithë me kombësi spanjolle dhe marrin pjesë në emrin dhe të drejtën e tyre, përveç të parit dhe të fundit.

I pari e bën këtë në emër dhe përfaqësimin e shoqërisë tregtare anonime të përbashkët "INMOBILIARIA NOSTRA, S.A." --- me seli në Madrid, me kohëzgjatje të pacaktuar, objekti i të cilës është shitja e pasurive të paluajtshme dhe çdo lloj tregtie tjetër ose industrie që lidhet me të mëparshmen, e themeluar nëpërmjet aktit të datës 28 Shkurt të vitit 1952 para Noterit të Pozuelo de Alarcon (Madrid), Z. Mario Armero Delegado, dhe ndryshuar nga vijueset të autorizuara nga I njëjti Noter, në Navalcarnero më 28 Tetor të vitit 1958 dhe në Bilbao më 12 Nëntor të vitit 1959 dhe para meje, me rritje të kapitalit më 18 Gusht të vitit 1966.

Është regjistruar në Regjistrin tregtar të kësaj Krahine, në vëllimin e përgjithshëm 774, 331 të Seksionit 30 të Librit të Shoqërive, fleta 19, faqe numër 2,470, mbishkrimi 9.

Ekzekuton vendimin e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë në fjalë, në mbledhjen e saj të mbajtur më 1 Shtator 1966, e cila paraqitet në vërtetimin që më paraqitet dhe e bashkëlidh në këtë akt, lëshuar nga Z. Francisco González Serrano Rives, Sekretari i Këshillit Drejtues të Shoqërisë në fjalë, me miratimin e Presidentit të saj, Z. Miguel Castillo Salvados, nënshkrimet e të cilit unë i njoh dhe i konsideroj të ligjshme, duke konstatuar ushtrimin aktual të të cilave në kompetencat e tyre përkatëse.

Dhe i fundit në emër dhe për llogari të Z. JOSE DIAZ CRISTÓBAL, në moshë madhore, i martuar me Znj. Blanca - González Serrano Rives, me kombësi Spanjolle, Avokat dhe resident në Madrid Fernando El Católico, 80, për shkak të kompetencave, plotësisht në fuqi, sipas sa ai pohon, se i është dhënë atij me një akt të dhënë para meje, në 14 tetor 1966, numër 3,245 e protokollit tim, kopje të autorizuar e së cilës më paraqitet dhe të cilës unë i transkritoj kompetencat: jo e modifikuar, e kufizuar, ose e kushtëzuar:

"Themelojnë shoqërinë aksionare të quajtur" TECNICA Y PROYECTOS S.A. "ose atë që në këtë rast emërtohet me marrëveshje me një shoqëri tjetër të themeluar, duke kontribuar me dhjetë mijë pesetë cash; pranon veprimet që i janë caktuar të përfaqësuarit; harton, nënshkruan ose ndryshon Statutin sipas të cilit do të drejtohet Shoqëria, duke përcaktuar në të emrin, objektin, kohëzgjatjen, adresën, aktivitetet, organet drejtuese dhe administrative, si të veprojnë këto dhe marrëveshjet e tjera që i konsideron përkatëse; pranon pozicione shoqërore dhe cakton njerëz për; ato; dhe merr pjesë në Borde ose takime me zë dhe me të drejtë vote, duke ndërhyrë në akte të tilla me kompetencat më të gjera dhe t'i jepi për atë efekt sa më shumë dokumente publike dhe private, përfshirë korrigjimin ose sqarimin.

NJOHJA, KOMPETENCAT DHE KUALIFIKIMET:

Unë i njoh palëve që paraqiten; që ata kanë, për mendimin tim, aftësinë e nevojshme ligjore, të cilën ata sigurojnë se nuk është e kufizuar, për të dhënë realizuar këtë statut të shoqërisë dhe

PARAQESIN

Se ata kanë rënë dakord për krijimin e një shoqërie të kufizuar publike, duke e verifikuar atë me anë të aktit aktual në përputhje me sa vijon

KLAUZOLA

E PARA: "INMOBILIARIA NOSTRA, S.A." përfaqësuar nga Z.Miguel Castillo Salvadios, Z. Luis Ayuso Tejerizo dhe Z. José Díaz Cristóbal, ky i fundit duke u përfaqësuar nga Z. Javier Rodriguez Sastre Dia, përbëjnë ose themelojnë shoqërinë aksionare, të quajtur "TÉCNICA Y PROYECTOS, S.A." në anagram (T.Y.P.S.A) aktiviteti i të cilës fillon sot dhe qëllimi, kohëzgjatja, vendbanimi, kapitali, aksionet dhe marrveshjet e tjera të klauzolave me të cilat do të drejtohet janë regjistruar në Statut, të nënshkruara tashmë nga bashkimi i përmendur dhe i paraqitur në pesë fletë letre të zakonshme të shkruara, të cilat palët që paraqiten e dorëzojnë siç duhet, Noteri duke ia lexuar ato personave që paraqiten i konfirmojë dhe ratifikojnë ato, duke i paraqitur ato në një akt publik me anë të përfshirjes së tyre në këtë dokument, pjesë e së cilës ato bëhen pjesë integrale.

E DYTA: Kapitali themeltar është NJË MILION PESETAS, i përfaqësuar nga një mijë aksione prej një mijë peseta secili, te zotëruesi kur ato emetohen plotësisht, të numëruara rresht nga numri një në një mijë, të dyja përfshirë.

Kapitali i deklaruar është plotësisht i regjistruar, duke disbursuar njëzet e pesë përqind në mënyrën vijuese:

"INMOBILIARIA NOSTRA, S.A.". Përfaqësuar nga Z. Miguel Castillo Salvadios, nënshkruan nëntëqind e tetëdhjetë aksione, numrat një deri në nëntëqind e tetëdhjetë, të përfshira të gjitha, për një vlerë prej nëntëqind e tetëdhjetë mijë pesos, duke paguar njëzet e pesë përqind ose ndryshe dyqind e dyzet e pesë mijë pesos.

Z. Luis Ayuso Tejerizo, nënshkruan dhjetë aksione numrat nga nëntëqind e tetëdhjetë e një deri në nëntëqind e nëntëdhjetë, për një vlerë dhjetë mijë pesos, duke derdhur njëzetë e pesë përqind të vlerës pra dymijë e pese qind.

DHE Z. JOSÉ DIAZ, CRISTÓBAL, i përfaqësuar nga Z. Javier Rodriguez Sastre Diaz, nënshkruan dhjetë aksione të mbetura, numrat nëntëqind e nëntëdhjetë e një deri në një mijë përfshirë, për një vlerë prej dhjetë mijë peso, duke paguar njëzet e pesë përqind, ose dy mijë e pesëqind peso.

Kontribuesit kanë derdhur shumën e disbursimeve të tyre përkatëse, në të holla në Arkën e shoqërisë

E TRETA: Zotërinjtë që paraqiten ortak, sipas nenit. 14 të Statutit dhe 55 të Aktit të Shoqërive të Kufizuara Publike, e konsiderojnë të themeluar në një Asamble të Përgjithshme të Jashtëzakonshme, realizmin e së cilës ata e pranojnë unanimisht:

18.- Vendosin pesë numrin e anëtarëve të Këshillit Drejtues

28.- Ata emërojnë për pozicionin e Këshilltarëve:

Z. Luis Ayuso Tejerizo, Z. Ramón Zabala Castillo; Z. José Ignacio Casanova Fernández, Z. Pablo Bueno Sanz dhe Z. José Diaz Cristóbal.

Zotërinjtë e emëruar, të paraqitur dhe të përfaqësuar, pranojnë pozicionet e tyre përkatëse.

KATËR: Zotërinjtë që përbëjnë Këshillin Drejtues, dhe. të cilët e kanë pranuar pozicionin, mbajnë seancën e tyre të parë dhe unanimisht bien dakord të emërojnë:

President: Z. LUIS AYUSO TEJERIZO

Anëtarët: Z. RAMÓN ZABALA CASTILLO, Z. JOSE IGNACIO CASANOVA FERNÁNDEZ dhe Z. PABLO BUENO SAINZ.

Sekretar: Z. JOSÉ DIAZ CRISTÓBAL

Të gjithë zotërinjtë e përmendur, të dhënat personale të të cilëve shfaqen në këtë akt, pranojnë sipas si marrin pjesë, emërimet e tyre përkatëse.

E PESTA: Të pranishmit konstatojnë që nuk përfshihen në ndonjë paaftësi ligjore për ushtrimin e pozicioneve shoqërore, duke shprehur shprehimisht ndalimin e realizmit ose ushtrimit të së njëjtës personat e deklaruar të papajtuësëm me Dekret të Ligjit të 13 majit 1955.

EGJASHTA: Zotërinjtë që paraqiten më tregojnë vërtetimin epërshtatshëm të Regjistrin të Përgjithshëm të Shoqërive duke vërtetuar se nuk ka asnjë shoqëri të themeluar me të njëjtin emër si ky, duke premtuar të shoqërojë kopjet e këtij akti me vërtetimin në fjalë.

Unë i sqaroj perosnave të paraqitur paralajmërimet ligjore që lidhen me këtë akt, veçanërisht ato të një natyre fiskale dhe atë në lidhje me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar, duke qenë të vetëdijshëm.

JAPIN DHE AUTORIZOJNË:

Në këtë mënyrë personat që paraqiten, pasi u lexova këtë akt për zgjedhjen e tyre, ata e miratojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë.

Dhe unë, Noteri, vërtetoj atë që thuhet në këtë akt publik, të shpërndarë në tre fletë të klasës së katërmbëdhjetë, seria A. numrat 6.992.479 dhe dy vijueset . – Miguel Castillo Salvadias.- R. M. Zabala.- P. Bueno - Luis Ayuso.- Javier Rodriguez Sastre.- J .I. Casanova.-Nënshkruar: Javier Gaspar.- Protokolluar dhe vulosur.

SHENIM: Të njëjtën ditë të vërtetimit të tij unë dërgoj në Regjistrin e Përgjithshëm të Shoqërive pjesën që më korrespondon dhe themelimin e saj

Vërtetoj- Gaspar. Regjistruar

DOKUMENTE TË BASHKUARA

I.

INMOBILIARIA NOSTRA, S.A. - Madrid-8.- San Bernardo, 9799

Z. Francisco Gonzalez-Serrano Rives, Sekretari i Këshillit Drejtues dhe i Mbledhjeve të Përgjithshme të - Inmobiliaria Nostra S.A.

VËRTETON: Se në Librin e Procesverbaleve të Mbledhjeve të Përgjithshme të Shoqërisë, ka një që i referohet Asamblesë së Përgjithshme të mbajtur më 1 shtator 1966 në 10:00 në zyrën e regjistruar, San Bernardo 97-99, që transkriptuar fjalë për fjalë thotë kështu:

Në këtë: "Z. Alberto Colomina Botí, Znj. Arima Maria Isa Colomina de la Torre, Z. Emilio Colomina de la Torre Gonzlez Serrano, Znj. Vicenta Idves López, Gouzález- Serrano Blanca Gonzlez Serrano Rives, Z. Emilio Colomina Boti, Z. Jose Luis Gonzales Morais, Z. Miguel Castillo Salvadios, Z. Antonio Lluch Colomina, Z. Luis Ayuso Tejerizo, Z. Jose Samarro Antunez dhe Construcciones Colomina G. Serrano S. A. përfaqësuar nga z. Alberto Colomina Boti.

Në. Madrid dhe në orën dhjetë të 1 Shtatorit të vitit njëmijë e nëntëqind gjashtëdhjetë e gjashtë, mbledhen në selinë e shoqërisë, San Bernardo 97-99 zotërinjt që në lidhje me këtë shprehen, se përbëjnë dhe përfaqësojnë të gjith kapitalin aksionar që po kreditohet nga Z. Alberto Colomina Botí përfaqësimin që ai mban nga Construcciones Colomina G. -Serrano S.A në cilësinë e tij si Zëvendës President i Këshillit Drejtues dhe Drejtor i Përgjithshëm i të njëjtës.

Bien dakord unanimisht për të mbajtur Mbledhjen e Përgjithshme të Shoqërisë dhe mbledhjen aktuale.

Fillon mbledhjen Presidenti Z. Miguel Castillo Salvadios, duke informuar asamblenë për themelimin e ardhshëm të një Shoqërie të re, qëllimi i themelimit të së cilës do të jetë kryerja e Studimeve dhe Projekteve Inxhinierike, Arkitekturore dhe Ekonomike dhe emri i së cilës do të jetë Tecnica y Projectos S.A dhe do të ketë një kapital prej një million peso

Në shoqërinë e re, Inmobiliaria Nostra S.A do të ketë një shumicë absolute, pasi mund të regjistronte nëntëqind e tetëdhjetë aksione me të cilat do të themelohej, duke e konsideruar pjesëmarrjen e Shoqërisë si shumë interesante në Shoqërinë e Re, nga ana tjetër, rritja e madhe e arritur nga Kombi

Handwritten signature

ynë në ndërtim dhe teknikë në përgjithësi, e cila logjikisht do të rris përfitimin e Tecnica y Proyectos S.A.

Pas një diskutimi midis të mbledhurve, u ra dakord unanimitisht pjesëmarrja e Inmobiliaria Nostra S.A.. në shoqërinë Técnica y Proyectos S.A. duke nënshkruar nëntëqind e tetëdhjetë aksione për një shumë prej nëntëqind e tetëdhjetë mijë peso, duke u dashur të paguajë njëzet e pesë përqind të shumës së përmendur në shumën prej dyqind e dyzet e pesë mijë peso (245,000 peso)

Z. President Don Miguel Castillo Salvadios është shprehimisht i autorizuar të paraqitet para një Noteri Publik, në emër të Inmobiliaria Nostra S.A. në themelimin e Técnica y Proyectos S.A. të miratojë statutin, të regjistrojë nëntëqind e tetëdhjetë aksione dhe të miratojë vendimet që i konsideron të përshtatshme për një themelim të tillë.

Pas pezullimit të mbledhjes për gjysmë ore për hartimin e këtij Akti, i cili, kur lexohet tek aksionarët, miratohet unanimitisht, duke fuqizuar Kryetarin dhe Sekretarin për nënshkrimin e tyre, mbledhja mbyllet në orën njëmbëdhjetë e tridhjetë minuta të ditës së treguar "

Dhe për këtë regjistrim, unë lëshoj këtë vërtetim me miratimin e Presidentit, në Madrid, shtatë shtator njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë.

Francisco G. Serrano.- Nënshkruar.

- V2 B° PRESIDENTI Miguel Castillo Salvadios.- Nënshkruar

II.

STATUTI I SHOQËRISË ANONIME "TECNICA Y PROYECTOS S.A." (T.Y.P.S.A.)

KAPITULLI I

EMRI, OBJEKTI, ADRESA DHE KOHACIONZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 1. Me emrin "Tecnica y Proyectos S.A." është krijuar një shoqëri e kufizuar publike që do të respektojë normat e detyrueshme të legjislacionit aktual, dhe nga ky Statut, dhe çfarë nuk është parashikuar ende në to nga ky legjislacioni si plotësues.

Neni 2 – Shoqëria ka për objekt kryejën e studimeve dhe projekteve të Inxhinierisë Civile, Arkitekturës dhe Ekonomike, Inxhinierisë Civile, Hidraulike, Agronomike dhe zbatimet e saj; Inxhinieri Industriale, Detare, Kimis së Naftës, Studime Ekonomike, Kërkime të Tregut, Organizim, Kërkime Operacionale, etj.

Neni 3. – Selia e shoqërisë është vendosur në Madrid, calle de San Bernardo, numrat 97 dhe 99.

Neni 4 – Shoqëria themelohet për një kohë të pakufizuar, duke filluar veprimtarinë e saj në të njëjtën ditë të realizmit të aktit publik të themelimit.

KAPITULLI II

KAPITALI AKSIONAR DHE AKSIONET

Neni 5 – Kapitali aksionar përcaktohet në NJË MILION PESO, i përfaqësuar nga një mijë aksione prej një mijë peso secili, zotëruesit kur ato të lirohen plotësisht, numëruar radhazi nga 1 në 1000

Aksionet janë të regjistruara në Librin e Regjistrimit që për këtë qëllim, ai do të kryhet nga Shoqëria, në të cilën do të regjistrohen transferimet që do të kryhen të së njëjtës.

Neni 6. Titujt e aksioneve do të vendosen në ceqe të cilat do të jenë në zotërim të shoqërisë dhe do të qëndrojnë të vulosur nga kjo dhe të autorizuar me nënshkrimin e Presidentit dhe Sekretarit që mund të printohen në mënyrë mekanike të autorizuar ngal igji.

Deri në kohën e emetimit aksionet do t'u besohen aksionarëve të ruajtura në mënyrë të përkohshme, të emëruara, në përputhje me atë që përcaktohet në paragrafin 2 të - nenit 34 të Ligjit për Shoqëritë e Kufizuara Publike.

Mund të emetohen tituj të grupeve prej 10, 100 dhe 500, me karakteristikat e përmendura më sipër.

Neni 7. - Çdo aksion si pjesë e konsiderueshme e aksioneve të kapitalit i jep mbajtësit të tij legjitimitet cilësinë e ortakut, duke i atribuar atij të drejtat themelore të vendimmarrjes dhe ekonomike në menaxhimin e shoqërisë, në shpërndarjen e përfitimeve dhe në trashëgiminë që rezulton në rast likuidimi, e gjithë kjo në përpjesëtimin që korrespondon me shumat e tyre.

Neni 8. Për shkak të natyrës së pandashme të aksioneve, Shoqëria nuk do të njohë më shumë se një ortak, pronar të vetëm të secilit aksion. Bashkëpronarët e një aksioni do të duhet të caktojnë një person të vetëm për të ushtruar të drejtat e ortakut dhe do t'i përgjigjen bashkërisht dhe veçmas shoqërisë për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga gjendja e aksionarit.

Kur pronësia e një ose më shumë aksioneve ose të drejtat që e përbëjnë u përkasin njerëzve të ndryshëm, ushtrimi i të drejtave dhe pajtueshmëria me detyrimet e korporatave do të verifikohet, në përputhje me dispozitat e Aktit të Shoqërive.

Neni 9. - Aksioneri që synon të transferojë me çdo titull të gjitha aksionet e tij ose një pjesë të tyre, do të jetë i detyruar t'i ofrojë ato Këshillit, i cili, brenda një periudhe prej një muaji, duhet t'ua komunikojë atë anëtarëve të tjerë, në rast se dëshirojnë për t'i përvetësuar ato në përpjesëtim me pjesëmarrjen përkatëse në shoqëri.

Nëse, pas kalimit të afatit prej 15 ditësh nga një ofertë e tillë, asnjë aksionar nuk i komunikoi Këshillit vendimin e tij për të blerë kjo bie dakord për blerjen nga Shoqëria të aksioneve të tilla për t'i amortizuar ato, me uljen përkatëse të kapitalit.

Nëse Këshilli Drejtues nuk e merr marrëveshjen në fjalë brenda një periudhe të re prej 15 ditësh, aksioneri do të jetë i lirë të transferojë aksionet e tij siç e konsideron të përshtatshme.

Në rast të një mospërputhje në lidhje me çmimin, kjo do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, ajo do të përcaktohet me ekspertizë.

Nëse kërkesat e tilla nuk përmbushen, shitja ose transferimi do të jetë i pavlefshëm.

Neni 10.- Për nënshkrimin e aksioneve përfaqësuese për rritjen e kapitalit, ish aksionarët do të kenë të drejtë preferenciale në termat dhe kushtet e përcaktuara nga Këshilli Drejtues në përputhje me nenin 92 të Ligjit për Shoqëritë e Kufizuara Publike.

KAPITULLI III

DREJTIMDHE ADMINISTRIMI I SHOQËRIS

Neni 11. - Përfaqësimi, drejtimi dhe administrimi i Kompanisë i takojnë:

- 1) Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.
- 2) Këshillit Drejtues.
- 3) Drejtorit të Përgjithshëm.

SEKSIONI 1

MBLEDHJET E PRGJITHSHME

Neni 12- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve do të ushtrojë tërësinë e të drejtave shoqërore, si organi suprem i Shoqërisë.

Neni 13. - Mbledhjet e Përgjithshme do të jenë të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Mbledhja e Përgjithshme e Zakonshme do të thirret dhe mbahet në kohën, formën dhe me kërkesat e parashikuara në Ligj.

Mbledhjet e Përgjithshme të Jashtëzakonshme do të mbledhen në rastet e urdhëruara nga Ligji dhe kur Presidentët ose dy anëtarë të Këshillit Drejtues e konsiderojnë të përshtatshme dhe thirrja do të verifikohet, me formalitetet e përcaktuara me Ligjin për Mbledhjet e Përgjithshme të Zakonshme.

Neni 14. - Asambleja e Përgjithshme, e zakonshme dhe e jashtëzakonshme, do të konsiderohet se është thirrur dhe do të mbetet, e konstituuar në mënyrë të vlefshme, për të trajtuar dhe zgjidhur çdo çështje, me kusht që i gjithë kapitali i paguar të jetë i pranishëm dhe të pranishmit të pranojnë unanimisht mbajtjen e mbledhjes.

Neni 15- Të gjithë aksionarët kanë të drejtë të marrin pjesë në Asambletë e Përgjithshme dhe mund të delegojnë përfaqësimin e tyre, duke ia komunikuar atë me shkrim Shoqërisë të paktën

pesë ditë para mbledhjes . Personat juridik marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet përfaqësuesve ligjor. Do të jetë i vlefshëm delegimi për personat që nuk janë aksionist.

Neni 16 - Mbledhja do të marrë vendimet me shumicën e votive të pranishmëve, duke llogaritur një votë për çdo dhjetë aksione.

Në mënyrë që Mbledhja të jetë në gjendje të marrë vendime në mënyrë të vlefshme me rritjen ose zvogëlimin e aksioneve të kapitalit, transformimin, bashkimin ose shpërbërjen e Shoqërisë dhe, në përgjithësi, çdo modifikim të Statutit, shumica e parashikuar nga Ligji për raste të tilla duhet të respektohet.

Neni 17. - Mbledhjet e Përgjithshme do të kryesohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues, Sekretari i Këshillit që vepron si Sekretar. Nëse dështon, çdo Mbledhje do të përcaktojë njerëzit që do të mbajnë pozicionet e përmendura.

Neni 18.- Vendimet e mbledhjes regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga Presidenti dhe Sekretari, ose ata që i zëvendësojnë ato dhe do të akreditohen me vërtetime të lëshuara nga Sekretari me miratimin e Presidentit, ose ata që zënë vendin e tyre.

Neni 19. - Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Zakonshme

1.- Emërimi dhe përcaktimi i personave që do të formojnë Këshillin Drejtues.

2- Shqyrton dhe miraton drejtimin e shoqërisë.

3- Kontrollon dhe miraton, kur është e përshtatshme, Raportin Vjetor, Bilancin dhe Llogarinë e Fitimit dhe Humbjes për vitin.

4 - Miraton për shpërndarjen e fitimeve dhe alokimin në fondet e rezervave

5. - Emëron aksionarët si auditorët e llogarive, në përputhje me dispozitat e Nenit 108 të Ligjit.

6. - Miraton marrëveshje për ato çështje të rendit të ditës që i paraqiten vendimit të tij.

Neni 20 – Është përgjegjësi e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të pranojë dhe zgjidhë të gjitha çështjet që përshkruhen nga dispozita e detyrueshme të Ligjit, dhe gjithashtu të gjitha ato që, të përfshira në rendin e ditës, i nënshtrohen vendimit të tij.

SEKSIONI 2

KËSHILLI DREJTUES

Neni 21- Administrimi i Shoqërisë është përgjegjëse për Këshillin Drejtues ose personin ose personat të cilëve u ka deleguar kompetencat e saj. Për t'u emëruar Drejtor, nuk kërkohet cilësia e aksionarit.

Neni 22- Këshilli Drejtues do të përbëhet nga një minimum prej tre dhe maksimumi prej tetë Drejtorësh, që takohen lirshëm, madje edhe jashtë zyrës së regjistruar. Mbledhja e Përgjithshme është përgjegjëse për cendosjen e numrit të saj.

Neni 23 - Në mënyrë që Këshilli të rinovohet gjithmonë pjesërisht, tre nga Drejtorët e emëruar në Statut do të largohen nga posti i tyre për një periudhë prej katër vjetësh, dhe dy të tjerët për pesë vjet

Emërimet e njëpasnjëshme të Drejtorëve të emëruar për të mbushur vendet e lira që ndodhin pas përfundimit të afateve të sipërpërmendura do të kenë një kohëzgjatje prej pesë vjetësh, duke u rizgjedhur për kohë të barabartë, nëse emërimi nuk revokohet shprehimisht.

Drejtorët mund të rizgjidhen për një kohë të pacaktuar.

Nëse gjatë mandatit për të cilin ata janë emëruar, Administratorët lihen vakant, Këshilli Drejtues mund të përcaktojë përkohësisht personat që do t'i zënë ato derisa emërimet e tyre të pushojnë ose të ratifikohen nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 24- Këshilli Drejtues do të caktojë një Kryetar dhe një Sekretar nga anëtarët e tij, të cilët do të zëvendësohen në rast të mungesës nga anëtarët e caktuar nga vetë Këshilli Drejtues.

Neni 25 - Administratorët mund të japin përfaqësimin e tyre këshilltarëve të tjerë me anë të një letre speciale drejtuar Presidentit për çdo seancë, duke qenë në gjendje të japin votën e tyre dhe të përfaqësojnë.

Që Këshilli të konstituohet dhe vendimet e tij të jenë të vlefshme, pjesëmarrja e gjysmës plus një prej anëtarëve të tij të pranishëm ose të përfaqësuar do të jetë thelbësore.

Marrëveshjet do të merren nga shumica e të pranishmëve, të pranishëm personalisht dhe të përfaqësuar.

Procesverbalet e secilës seancë lëshohen në Librin përkatës, të autorizuar me nënshkrimet e Presidentit dhe sekretarit.

Neni 26 – Këshilli Drejtues ka kompetencat më të gjëra dhe kontributet për të përfaqësuar, organizuar, administruar dhe drejtuar shoqërinë në të gjitha mardhëniet dhe çështjet e saj, të mirat dhe të drejtat, me kompetencat mëq të gjëra, duke marrë të drejta dhe dhënë detyrime të cdo lloji juridik, të bëjë marrveshje, shesë, të japë garanci dhe hipoteka, duke përfshirë në Regjistrin Hipotekor të Spanjës dhe dhe bankat e tjera zyrtare, dhe në ndonjë mënyrë tjetër për të tjetërsuar dhe ngarkuar, huazuar para, hapur dhe anuluar llogari rrjedhëse, depozita dhe operacione të tjera, përfshirë në Bankën e Spanjës dhe Arkën e Përgjithshme të Depozitave dhe kryerjen e të gjitha llojeve të administrimeve dhe akteve të kontrollit të rreptë, të gjitha në lidhje me pronën, pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, delegojnë kompetencat siç e konsiderojnë të nevojshme, duke emëruar përfaqësues, drejtorë ose menaxherë dhe në përgjithësi, në favor të çdo personi me kompetencat, që ata i konsiderojnë të përshtatshme dhe i revokojnë ato.

Dhe në termat më të gjerë Këshilli Drejtues do të jetë i autorizuar të bëjë gjithçka që është e nevojshme ose e konsideron të përshtatshme në emër të Shoqërisë, dhe pa kufizime të tjera përveç

atributeve që Ligji i rezervon në mënyrë rigoroze Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve si ekskluzive të Kjo ose me dispozitë të shprehura të këtij Statuti.

Të gjitha kompetencat që i takojnë Këshillit Drejtues, përveç atyre që janë të ndaluara me ligj, janë tërësisht të deleguara në mënyrë të qartë te Presidenti dhe Sekretari.

SEKSIONI 3

MENAXHIMI I PERGJITHSHËM

Neni 27 - Po kështu, të gjitha kompetencat që i takojnë Këshillit Drejtues, përveç atyre që janë të ndaluara me ligj, i delegohen plotësisht Drejtorit të Përgjithshëm.

KAPITULLI 4

BILANCI, LLOGARIT VJETORE, REZERVA DHE FITIMET

Neni 28- Llogaritë vjetore të vitit do të mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, dhe Këshilli Drejtues do të paraqesë në Mbledhjen e Përgjithshme Bilancin me Llogarinë e Fitimit dhe Humbjes, -Propozimin për Shpërndarjen e Fitimeve dhe Raportin Shpjegues, të gjitha në përputhje me rregulloret ligjore në fuqi.

Neni 29. - Të ardhurat e marra në çdo vit fiskal duke zbritur sigurimet shoqërore, me zbritje të të gjitha shpenzimeve, pagat, shpërblimet dhe shtesat e të gjitha llojeve, pagesat kompensimet në proporcionin e përcaktuar nga këshilli, pagesa të interesit dhe maortizimin e obligacioneve do të nxjerin fitimin.

Përfitimet e sipë përmendura shpërndahen si më poshtë:

- 1- Shumat e nevojshme për të formuar fondin rezervë që është i detyrueshëm në përputhje me Ligjin.
- 2- Shuma e nevojshme për shpërndarjen e një dividendi prej katër përqind në aksione.
- 3- Shuma që Këshilli Drejtues e konsideron të duhur se përbën një fond providence ose rezervë vullnetare.
- 4 - Shuma që Këshilli Drejtues pranon të ndajë për të korrigjuar menaxhimin e punonjësve të Shoqërisë dhe personelit të menaxhimit të punëtorëve.
- 5- Dhe pjesa e mbetur për t'u shpërndarë si një dividend plotësues për aksionarët

KAPITULLI 5

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë

Neni 30 - Shpërbërja e Shoqërisë do të realizohet brenda afateve të përcaktuara me Ligj dhe në përputhje me të njëjtin, likuidimi i saj do të vazhdojë në raste të tilla.

-Miguel Castillo Salvadios.- Luis Ayuso.

- Javier Rodriguez Sastre.- nënshkruar

VËRTETOJ se ËSHTË KOPJE E PARË e origjinalit të saj që nën numrin e regjistrimit të treguar në fillim, shfaqet në protokollin tim aktual të instrumenteve publike, ku shënohet. Dhe me kërkesë të Shoqërisë së themeluar, unë e lëshoj atë në shtatë kopje 14g, Seria A. numrat 7,016,927; 7,016,928; 7,016,926; 7,016,726 dhe tre në vijim, që vijojnë, nënshkruar, regjistruar dhe vulosur në Madrid më njëzetë e shtatë Tetor të të njëjtit vit të regjistrimit të tij.

(firma dhe vula e noterit)

(e pa lexueshme)

MADRID

Regjistri i Shoqërive

Ky dokument është nxjer për efekt të regjistrimit të Shoqërive

Madrid më 16 Nëntor 1966

(firma dhe vula)

Ky dokument është regjistruar në Regjistrin Tregtar të kësaj province, volum 2078 i përgjithshëm 1459 të seksionit 3 të librit të shoqërive, fleta 38 faqe 11873 inskriptim 1

Madrid 5 Janar 1967

(firma dhe vula)

Legalizim. Regjistrimet e Kolegjit të Noterëve legjilzojnë nënshkrimin e noterit.

Madrid më 12 Nëntor 1968

(firma dhe vula)

SHËNIM: Vërtetoj se më 26 shkurt 2007, është paraqitur dëshmi e kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 61.

[Handwritten signature]

SHËNIM: Vërtetoj se më 26 Mars 2007, është paraqitur dëshmi e kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 153.

SHËNIM: Vërtetoj se më 26 shkurt 2007, është paraqitur dëshmi e kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 61.

SHËNIM: Vërtetoj se më 23 Maj 2007, është paraqitur dëshmi e kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 299.

SHËNIM: Vërtetoj se më 10 shtator 2007, është paraqitur dëshmi e kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 1716.

SHËNIM: Vërtetoj se më 13 shkurt 2007, janë dhjetë paraqitur dëshmi të kësaj kopje. Shënuar në librin e protokollit me nr. 2.055.

SHËNIM: Vërtetoj se më 16 janar 2008, janë paraqitur njëzetë kopje të këtij dokumenti në emër të shoqërisë "TECNICA Y PROYECTOS S.A". Shënuar në librin e protokollit me nr. 11.

SHËNIM: Vërtetoj se më 8 shtator 2009, janë paraqitur dhjetë kopje të këtij dokumenti në emër të shoqërisë "TECNICA Y PROYECTOS S.A". Shënuar në librin e protokollit me nr. 1743.



VÈRTETIM I NOTERIT PËR DOKUMENTIN E PARAQITUR

VÈRTETIM: Unë ALVARO OBANDO BIGERIEGO, noter i Kolegjit të Noterëve të Madrid- it, me seli në San Sebastian de los Reyes, VÈRTETOJ SE: Se fotokopja e mëparshmja, në shtatë pesë fletë të përdorura në pjesën e përparme dhe të pasme, të përmbajtura në pesë fletë letër e posacme për dokumentet noteriale të serisë FB4615198 dhe katërbëdhjetë në vijim në rendin zbritës dhe aktualja janë riprodhim i saktë i kopjes së autorizuar të aktit, që më është paraqitur dhe që e kthej.

Në San Sebastian de los Reyes, më njëmbëdhjetë mars të vitit dymijë e njëzetë. NUMËR / 232/ TË LIBRIT TIM.

(firma, vula pulla e noterit)

Alvaro

FJ5568874

03/2020

= SHKRESË PËR LEGALIZIM PËR KOLEGJIN E NOTERËVE TË MADRID- it

Kjo shkresë është bashkuar me vulën e Kolegjit të Noterëve dërguar nga

D. Alvaro Obando Bigeriego

Noter në San Sebastian de los Reyes

Më datë 11/03/2020

APOSTILË

(Konventa e Hagës e datës 5 Tetor 1961)

1. Shteti SPANJË

Ky akt publik

2. Është nënshkruar nga D. Alvaro Obando Bigeriego
3. Që vepron në cilësinë e Noterit
4. Është pajisur me vulën e Noterit

Vërtetohet

5. Në MADRID
6. Më datë 14/09/2020
7. Nga Dekani i Kolegjit të Noterëve të Madrid- it
8. Me numër N7201/2020/042226
9. Vula
10. Firma

Z. Emilio Leal Labrador

Nënshkrim i deleguar i Dekanit

Kjo apostilë vërteton vetëm nënshkrimin, funksionin në të cilin ka vepruar nënshkruesi i dokumentit në këtë rast vërtetësinë e vulës të cilën mbart ky dokument publik.

Kjo apostilë nuk vërteton përmbajtjen e dokumentit për të cilin është lëshuar.

Kjo apostilë nuk është e vlefshme për përdorim në Spanjë

Për të verifikuar lëshimin e kësaj Apostile ju lutemi shikoni. <http://sede.mjusticia.god.es/eregister>

Kodi i verifikimit të apostilës : NA:EleD- V7jE – Ovs2-bQOO

Alma Kasha

[Signature]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER LAURA L. PUSTINA**

**DATE 16/11/2020
NR REP 3648**



V2020053330203319401

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 16/11/2020, para meje Notere LAURA L. PUSTINA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ABDYL FRASHERI, NR.31, NR.6, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Alma Koxha, atësia Sotir, amësia Liri, shtetase Shqiptare, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Rr.Mikel Maruli; Nd. Ap.38; H. Shk.1; Kashar; Yzberish; 1052; Tiranë, lindur më 12/04/1986, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032180946 dhe nr. personal I65412097I, .

Përkthyesja e pranuar nga pala që paraqet dokumentin, më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Statut i Tecnica Y Proyectos SA, nr. FB4615189”, nga gjuha Spanjisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë;” në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER
LAURA L. PUSTINA**

